



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**VENDIM**  
**Nr. 97, datë 09.03.2022**

**PËR**  
**DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 44, DATË 31.01.2022, TË KËSHILLIT TË LARTË**  
**GJYQËSOR, “PËR PËRFUNDIMIN PARA AFATIT TË SHËRBIMIT NË SKEMËN E**  
**DELEGIMIT, PËR GJYQTAREN ZNJ. {...}”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 25, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, si dhe në Vendimin Nr. 593 dt. 23.12.2021 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...} ;

**VENDOSI:**

Pas pikës 2, të Vendimit nr. 44, datë 31.01.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren {...}”, shtohen pikat 2.1 dhe 2.2 me këtë përmbajtje :

2.1 Rindarjen me short të të gjitha çështjeve në shqyrtim nga gjyqtare {...} si dhe atyre të caktuara për shqyrtim si relatore, deri në datën 01.02.2022.

2.2 Vijimin e procedurave për plotësimin e trupave gjykues ku gjyqtarja {...} ka qenë anëtare deri në dt. 01.02.2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**